



Bejza Isaki lindi në Tetovë, bashkëjeton me familjen në f. Trebosh. Është nxënëse në klasë të tetë në Shkollën fillore komunale “Fan Noli” të f. Trebosh. Me krijime letrare është marr që nga klasa e pestë. Poezia e parë e postuar te faqja e shkollës ishte “E mira” me të cilën nis rrugëtimin deri në botimin e këtij libri me vjersha.

Me krijimet letrare poetike merr

pjesë në shumë aktivitete e gara të ndryshme shkollore e komunale. Është antare e Shoqatës së Shkrimtarëve të Tetovës “Oeneum”

Është krijuese e mirë dhe ardhmëria krijimtarisë letrare në trevat tona dhe më gjërë.

Bejza Isaki
Cepëza jete

COPËZA JETE

BEJZA ISAKI

B e j z a I s a k i

Copëza jete

Tetovë

2024

Sekreti i krijimtarisë është të dish të fshehësh
burimet

E mira

Në një botë jetojmë
Dhe të mirën se kuptojmë,
Njerëzit çdo ditë na ndihmojnë
Dhe të mirën nuk duhet t'ua harrojmë.

Mendoj, shumë mendoj
Te keqen nga mendja ta largoj,
Që në jetë gjithmonë
E mira të mbizotroj.

Jam Unë

Unë jam ajo që shpresoj,
Sot, nesër e gjithmonë.

Unë jam ajo që dashoroj,
E askuj, dorën s'ia lëshoj.

Unë jam ajo që nuk xhelozoj,
E askujt mundin s'ia shqelmoj.

Unë jam njeri me shumë ëndrrime,
Dhe pres shumë në të ardhmen time.

Me ty bukuroshe

Sa shumë përgojime

Dëgjoja për veten time,

Vazhdoja t'ianashkaloja

Vetëm punën time të shikoja,

Siç thotë thënia

“Me ty bukuroshe, që kurr nuk u fundose”.

.

Babi

Mendoj e mendoj
Babit tim se sa e dua si t'i tregoj,
Më rriti me shumë dashuri,
Mundin që ka dhënë për mua
Kurrë s'mund t'ia harroj
Andaj me vargje e dashuri
Jam duke shkruar një poezi
Sa shumë të dua unë ty,
Edhe kapituj nëse shkruaj
Edhe një roman histori
Mundin dhe dashurinë tënde
Nuk mund ta përshkruaj
Nuk më mbërrijnë fjalët e shkronjat!

Nëna

Me shumë përkujdesje
Gjatë jetës më mbajti,
E për mua shumë qau,
Zemra e saj e di,
Sa më do ajo tani.

Këtë poezi e shkruaj,
Por mundin s'mund t'ia paguaj,
Ke një vend të veçantë në zemrën time,
Sa shumë të dua Nëna ime.

Edukimi i mendjes pa edukimin e zemrës nuk
është aspak edukim.

Yll veriu

Ecja e saj tekanjoze

E shikoja

U gëzova nga ajo dhimbje

Paradoksale

Ndiqja hapat e saj

S'munda veten ta mbaj

Nënqesha vetvetiu

YLL VERIU!

Mërgimtari

Larg familjes jetoj,
Me lot në sy qëndroj,
Kam shumë mall, e digjem si zjarr.

Dua të kthehem në vendlindje,
Se atje kam lënë familjen time.

Po më presin ç'do ditë me mall e kujtime,
Sa shumë të dua moj vendlindja ime.

BEJZA

Bota ka shumë njerëz
E gjithë s'jemi njësoj
Jeta është shumë e bukur
Zaten të gjithë njerëzi të këndojmë
Ardhmëri të sigurojmë

Injorimin ta largojmë
Sa më mirë të jetojmë
Ardhmëri e mirë na pret
Kjo botë e lumtur do të jetë
Imërzitur mos tëjetë ai që ka mbet.

(poezi akrostike)

Vlerë jete

Pashë një ëndërr
Diku lart në qiell
Atje nuk kishte diell,
Kishte vetetima të thella
Thoja: Ah,unë e mjera
Askush nuk më zgjati dorën
Nga i ftohti u bëra dru.
Doja ta prekzemrën time
Të marr ngrohtësi,
Por jo dhe ajo ishte duke u djegur
Shkrum e hi,
Pas disakohësh
Shpirti im shkoi lartë në qiell
Dhe e dija s'do rezistojë gjatë.
Kësaj here
Hapa sytë, ishanë gjumë
Isha si me më godit një plumb,
Ishte ëndërr me shumë kuptime
E që nga ajo ditë fillova
T'ia di vlerën jetës sime.

Unë nuk kam gjithçka që dua, por dua gjithçka
që kam

Jeta

Është bërë si një lojë
Qës'mund as vetë ta udhëheqim,
S'ke orientim, s'ke asgjë
Vetëm brenda të përfol një zë
Edhe shikon që ke ndryshuar,
Jo, jo s'je e njëjta
Po njerëzit që tërrethojnë a kanë ndryshuar?!
Jo, se dhe ato janë bërë njëjtë
Njëri-tjetrin duke kopjuar.
Po unë...
Çfarë mësova,
Edhe sytë e bukur të mashtrojnë
Edhe zemra e pastërt pispilloset,
Dhe në fund thellë në një vend varroset
Dhe s'ndjen,
S'ndjen asgjë si më përpara
Asgjë s'të shkon nga e mbara.
Ai fat që më përcolli
S'dimë a do më përcjell,
Vetëm nëse mundesh zemrën t'ma zhgroposh
Sepse ka qenë shumë, shumë thellë.

Sakam fjalë

Sakam fjalë

Po aqs humë mall

Vetes s'mund t'ia fal.

Të të dua apo të dal

Te një krua të ulem e të pushoj,

Të kthehem e të mendoj se si të veproj.

Dashuria jo më mbeti

Një roman pa fjalë e fjali,

Dashuria jo më mbeti

Si një pikë në oqean.

Koha sot

Njerëzit kanë ndryshuar,
Nuk janë më si dje,
Kanë vendosur maska të reja,
Të vjetrat i kanë hequr dje.

Koha kalon e ato s'ndryshojnë,
Mbesin të këqinj e në fund vetë pësojnë,
Atë që e pësojnë nuk do ta harrojnë,
Do kërkojnë falje e do mundohen,
Të gjejnë një rrugë dalje.

Nuk harrohej

Vendosa u largova
Larg dashurisë jetova
Dhe më pas shumë e kërkova,
Por nuk e gjeta
Përsëri vetë mbeta.
Mundohesha ta nxjerr nga mendja
Po jo nuk largohet,
Vazhdoja e mendoja
A është lodhur, a ka pushuar,
A është sëmurë a është shëndoshë
Nga mërzia me të, a duhej të vajtoja,
Të bëj hap para
Jo se më duket gabim,
Edhe pse nuk e kontaktoj
Vazhdoj e dashuroj.

Njeriu që do

Sot e njeh e nesër s'të njeh,
Të del përpara e të thotë ku je?

Të mban në zemër
E pastaj të flak tutje,
Nesër të del përpara
E dëshiron jetën të ta ndreq.

Sa çudi kjo dashuri
Ndonjëherë ulem e mendoj
Pa dashuri s'mund të jetoj.

Një libër i bukur kthehet në një ngjarje
në jetën time

Kohë kalimtare

Orë tecin por të duket
Se akrepat nuk lëvizin,
Kohën nuk mund ta shtyj
Por zorr të kalohen pa ty
3,153,600 sekonda të vitit
Mu mblodhën në mendje,
Nuk mund t'i llogaris si i kam kaluar
Nuk mund të të përshkruaj ty
E as karakterin tënd,
Por mos harro edhe pse nuk je
S'ta zë askush vëndin tënd.

Sikur ta dija

Atë natë më erdhi një fuqi
Dhe papritmas të lash ty,
Ku ta dija që ty shumë do të dashuroja
Saqë sytë e mi t'i verboja,
Ti më the "Ndoshta tani do ndjehesh më e lirë"
Prej atë ditë s'ndjej as gjë përveç zbrazëtirës,
Zemra të mban por krahët nuk munden
Gjysmën time e morre me vete
Por edhe ti pa gjysmën mbete.

Se di pse...?

Jam e heshtur por më thonë se flas shumë
S'më kuptojnë, mbrapsht reagojnë,
Jam njeri, bëj gabime,
Më duket se vetëm unë e kuptoj veten time.

I them vetes vazhdo ti mundesh
Të tjerët mos i dëgjo,
Më të mirën një jetë
Realizo ëndrrën duke besuar veten tënde...

Nëse beson tek vetja, herët a vonë do e keshatë
që e do në jetë

Unë

Unë jam ajo që shpreson,

Unë jam ajo që ndihmon,

Unë jam ajo që dashuron,

Nuk jam ajo që xhelozon,

Por si çdo herë jemi vetvetja jonë.

Kuptova

Kuptova se nuk
Kisha një shoqëri,
Përkundrazi, një armiqësi.
Koha me tregoi shumë gjëra
Edhe unë shumë gjëra mësova,
Kuptova, u tregova
Të tjerëve se çfarë përjetova.
Disa më besuan,
E nga disa që se prisja,
Nuk di pse më anashkaluan.
Mësova se nuk duhet
Ti besojmë gjithkujt,
Se në fund na mashtrojnë
Të mirën tonë e harrojnë.
Thash me vete
Më mirë në vetmi
Se sa me një shoqëri
Që në fund të bëhet armiqësi.

Vetvrasje

U ula e mendoja të bëja
Vetëvrasje se zemrën ma coptoi,
Por një zë nga brenda
Nuk më linte të qetë,
Mos bëj kështu marrëzira në jetë,
S'isha aspak rehat deri sa një natë
Në ëndërr e pashë veten time
Jeta është e bukur përfundimisht thashë.

Jeto jetën tënde

Ëndrro jetën tënde

E jo ëndrrën e huaj,

Jeto jetën tënde,

Mos lejo ndërhyrje nga ndonjë i huaj.

Të paktën edhe në ëndrra mos ndërhyj,

Të paktën edhe në jetën

E dikujt tjetër mos u përziej

Mos fol për të tjerët,

Kur nuk dëshiron për ty të flasim,

Mos fol pas shpinës së dikujt tjetër,

Sepse në fund ty të godasin.

Mos mendo kurrë keq për dikë,

Kur nuk dëshiron as për ty keq të mendojnë,

Mos xhelozo tjetrin, xhelozia të dëmton,

Kur përul tjetrin, karakterin tënd e tregon.

Thjesht në punët e të tjerëve mos ndërhyj,
Leri thashethemet meru me punët e tua,
Leri njerëzit si të duan të jetojnë,
Ti thjesht mos ndërhyj
Sepse në atë gjendje
Një ditë mund të ndodhesh edhe ti.

Errësirë

Frikësohem të rri
Në errësirë,
Më duket sikur toka
Më ka përbirë.
Nuk mund ta shoh
Të ardhmen time,
Nuk mund ta ëndërroj,
Ëndrrën time.
Errësirën në ditë
A e keni parë?
Kur njeriun pikëllimi e mbulon
Anë e mbanë.
Edhe pse është ditë,
Për dikë bëhet errësirë,
Sepse hidhërimi njeriun
E kaplon, e tërbon.
A keni parë qiell pa yje?
Sikur mali pa pyje.
A keni parë njeri që nuk ëndrron?
Pikërisht atë, errësira e shkakton.

Ajo

Ajo erdhi e më tha,
Leri të tjerët se çfarë flasin,
Jetën shijoje, më kapni për dore
Në një vend më dërgoni,
Shiko këtu s'ka brenga s'ka mërzi,
Këtu ekziston vetëm fjala lumturi.

Këtu çfarë të duash mund të bësh,
Të jetosh pa brenga, të jetosh në harmoni,
Vallë a dëshiron një jetë të këtillë ?

Këtu lulet lulëzojnë
Me aromën e tyre të lumtur të bëjnë,
Me erën, këtu gjethet vallëzojnë,
Aty ku malet dhe lumenjtë të rrethojnë.
Me kapi dorën me tha eja se ka akoma kohë,
Aty hapa sytë dhe nga ëndrra u zgjova.

Dikush më tha....

Dikush më tha, kështu është jeta....

Mu duk se flet gënjeshtër,

Por jo, kështu qenka e vërteta

Kjo ishte jeta.

Për ta ndryshuar nuk mund ta ndryshoj

Vazhdoj e më shumë dyshoj,

Se si njerëzit të nesërmen e presin

Do jetojnë apo do të vdesin?...

Koha ikën

Mes nesh ndodhi diçka
Nuk dija si ta quaj,
Herë të lumtur
Herë të mërzitur,
Nga ti mesazhe duke pritur.

Kaluan shumë javë
Nuk u ndëgjuam,
Deri sa një ditë
Me njëri tjetrin u bashkuam.

Buzëqesh

Për një moment,
Të gjitha brengat largohen,
E gjërate mira shtohen.

Është moment gëzimi,
Nuk është moment pikëllimi.

Njerëzit duhet
Të mendojnë pozitivisht,
E jo negativisht.

Buzëqesh edhe pse je e mërzitur,
Të tjerët të mos e dinë,
Sepse nga inati ,
Çfar nuk mund të bëjnë.

Kështu, që buzëqesh,
Ashtu edhe lumturinë
Një ditë do e gjejsh.

Dikush

Dikush është i lumtur,
E dikush i hidhëruar,
Dikë errësira e ka kapluar.

Dikush çdo ditë punon,
Dikush çdo ditë ri,
Për faqe të zezë jeton.

Dikush ardhmërinë ëndrron,
E dikush në ëndrra nuk beson.

Dikush ka lirinë e se shijon,
Dikush brenda katër mureve,
Nga një dritare e vogël
Jashtë shikon.

Dikush ka pasuri
E vlerën nuk ia di,
Dikush ka varfëri
Skamjes vlerën ia di.

Dikush pa mangësitë përqesh,
Ti ndjehesh keq
Natën s'mund të flesh.

Dikush natë e ditë punon,
Diçka të fitojë,
E ëndrrat që i ka
Një ditë t'i realizojë.

Gjërat më të bukura duhet të luftosh për t'i pasur
...dhe kur i ke, duhet të luftosh për t'i mbajtur "

Meteor

Si meteor të shikova,
Me ndriçimin e syve tu,
Të mijt i verbova.

Thuaja

Kur e di që jeta është e shkurtër,

Kur e di se diçka është e shenjtë për ty,

Kur e di se e ke një dashuri,

Pse pret, thuaj se të nesërmes si dihet,

Thuaj TË DUA me zemër sepse e do atë njeri.

Bashkë

Dua vepra e jo vetëm fjalë
Furtunave t'ju bëjmë ballë,
Jo me dy fjalë ti të besosh
Me fjalë njeriun që do, do e sulmosh,
Pse të lumtur atë mos ta bësh.
Ti hudhësh fjalë...
Fjalët duhet t'i kontrollojmë
Eh, kur bëhet fjalë për njeriun që dashurojmë.

Fat i tij

Sillej si iluzion,

S'gjente dot rrugën,

Për ta kthyer atë,

Atë vajzë që i ndryshoi jetën,

Idinjata e tij ishte shumë e fortë,

Dhe kështu humbi vajzën,

Që pa të, nuk jetonte dot.

E dua!

Sa ujin në oqean

E dua,

Sa diellin në verë

E dua,

Sa fjalët e qiellit

E dua.

Disa fjalë rreth veprës dhe autores

Nuk është thënë më kot që poeti në secilën poezi të tij lë diçka nga vetja qoftë edhe një shenjë të vogël.

Libri është ai i cili i dërgon njerzit në rrugën e drejtë, në botën e endrrave. Jo me kot edhe krijuesja e re, Bejza Isaki, në poezitë e saja shfaq ndjenjat, trishtimin, brengat si edhe momentet e bukura të jetës së saj. Gjithçka për rreth një poeti është poezia, është krijimi i fjalës së bukur. Ai di si ta vesh dhimbjen, ai di si ta zbukuroj poezinë me fjalët e shenjta, ashtu siç bën edhe poetja Bejza Isaki. Deri te botimi i një vepre edhe Bjeza ka hasur vështërsi të ndryshme, por fakti që ajo vazhdon të krijoj e motivoj bashkëmoshanikët premtan shumë për të ardhmen.

Bejza shpreson për të ardhme të mirë, në poezinë "Unë jam" ndër të tjera në vargjet e saja thotë

Unë jam ajo që shpreson,
Sot nesër e gjithmonë.

Unë jam ajo që dashuron
E askuj dorën s'ja lëshon.

Në vargjet e permendura pak me lartë ajo tregon se kush është dhe se çfarë dëshiron. Tematika që trajton në poezitë e saja është e nduar ndurshme.

Krijon vargje temën sociale, u kushton vargje edhe prindërve, shkollës, festave të ndryshme kombëtare dhe shumë tema të tjera të cilat na mbërthejnë për realitetin dhe na bëjnë të imagjinojm.

Ne krijimtarin e saj Bejzen e brengos një fakt se sa shumë ka ndryshuar koha e njerëzimit sot nga ajo që ka dëgjuar nga më të vjertit, e këtë e shpreh në poezinë e saj "Koha sot" .

Njerëzimit kanë ndryshuar,
Nuk janë më si dje
K kanë vendosur maska të reja
Të vjetrat i kanë hequr dje.

Bejza është një vajzë që ëndrro për një të ardhme të mirë, duke bërë një hap me botimin e librit të parë të saj. Është një krijuese dhe talente e re e cila premtonte shumë rreth botës së poezisë dhe librit. Në përgjithësi krijimet e Bejzës janë reflektim ndaj botës në të cilën jeton edhe autorja.

Reflekton mbi atë që e sheh, ndjenë dhe e kupton, e mbi të reflekton duke dhënë edhe ide se si duhet të ndryshohet edhe ardhmëria e saj në veçanti, dhe ardhmëria e shoqërisë në përgjithësi. Në vargjet e saja ka qartësi, kuptimësi, mesazh i cili ka vlerë për të gjitha kohërat. Poezitë e Bejzës edhe pse në tematikë të ndryshme, struktura e tyre është unike, janë të kompozuar estetikisht bukur e me shije. Libri "Copëza jete" besoj se do ketë një jehonë më të madhe në qarqet tona letrare, që do e çojnë Bejza Isakin në rrafsh më të larta të poetikës së sajë.

Nga Merita Isaki

Falemenderim

I falemenderoj të gjithë ata të cilët më mbështetën moralisht e materialisht që edhe unë të arij të kurorëztoj punën time dhe të realizoj ëndrën time që të rradhitem në mesin e krijuesëve të rinjtë vendit tim.

Falemenderoj familjen time për përkrahjen morale e materiale. Një falenderim të singertë për arsimtarin Muaxher Haruni, i cili më ka përkrahur e ndihmuar deri në botimin e kësaj vepre.

Të nderuar lexues të fjalës së bukur, ju faleminderoj që lexuat librin tim të parë. Ishte kënaqësi për mua të ndaja me Ju këtë vepër.

*Me respekt
Bejza Isaki*

Përmbajtja

<i>E mira</i>	4
<i>Unëjam</i>	5
<i>Me ty bukuroshe</i>	6
<i>Babi</i>	7
<i>Nëna</i>	8
<i>Yll veriu</i>	10
<i>Mërgimtari</i>	11
<i>BEJZA</i>	12
<i>Vlerë jete</i>	13
<i>t'ia di vlerën jetës sime.</i>	13
<i>Jeta</i>	15
<i>Sa kam fjalë</i>	16
<i>Koha sot</i>	17
<i>Nuk harohej</i>	18
<i>Njeriuqë do</i>	19
<i>Kohë kalimtare</i>	21
<i>Sikur ta dija</i>	22
<i>Sedi pse...?</i>	23
<i>Unë</i>	25
<i>Kuptova</i>	26
<i>Vetvrasje</i>	27
<i>Jetojetëntënde</i>	28
<i>Erësirë</i>	29

<i>Ajo</i>	30
<i>Dikush më tha</i>	31
<i>Koha ikën</i>	32
<i>Buzëqesh</i>	33
<i>Dikush</i>	34
<i>Gjërat më të bukura duhet të luftosh për ti pasur</i>	35
<i>Meteor</i>	36
<i>Thuaja</i>	37
<i>Bashkë</i>	38
<i>Fat i tij</i>	39
<i>E dua!</i>	40
<i>Disa fjalë rreth veprës dhe autores</i>	41
<i>Falemenderim</i>	43
<i>Përmbajtja</i>	44

Botues: Shoqata Jo Qeveritare “TREBOSHI”

Autore: **Bejza Isaki**

Titulli: “Copëza jete”

Redaktor : **Muaxher Haruni**

Lektor: **Mr. Sadije Haliti**

Recezente: **Merita Isaki**

Korigjimi: **Arta Velija**

Rradhitja & kopertina: **Emin Haruni**

Shtypi : **Mjeksia**

Tirazhi: **300 kopje**

ISBN:987-608-4972-17-4

Botimin e këtij libri e sponsoroi

